



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni IV

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr. 40

Prishtinë, më 18.05.2012 në ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Goran Marinkovic, Elmi Reçica, Albert Kinolli, Lumnije Morina, Lirije Kajtazi, Jasmina Živkovic, Jelena Bontic, Rasim Demiri dhe Xhevdet Neziraj

Mungon:, Glauk Konjufca, Petar Miletic dhe Mufera Sinik.

Emrat e të ftuarve dhe pjesëmarrësve tjerë: përfaqësues të OSB-ja Elita Vokshi, Lejla Selimi, përfaqësuesi nga KDI-Sakibe Jashari, dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit: Kordinatore - Natasa Prica-Tisma, zyrtare e lartë ligjore, Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: Goran Marinkovic, kryetari i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës**
- 2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të kaluara.**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-109 për Komunikimet Elektronike, me raportin e Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, tregëti dhe Industri, me amendamente**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-95 për Diasporëne e Kosovës, me raportin e Komisionit funksional për Arsim, Kulture, Rini, Sport, AdministratëPublike, Qeverisje Lokale dhe Medija, me amandamante.**
- 5. Të ndryshme**

Kryesuesi - konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesi – konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të kaluara.

Kryesuesi -konstatoi se komisioni njëzëri miratoi procesverbalin e mbledhjeve të datës 17.04.2012, dhe 26.04.2012, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-109 për Komunikimet Elektronike, me raportin e Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, tregëti dhe Industri, me amendamente

Kryesuesi, paraqet për shqyrtim propozim amendamentet në **nr.04/L-109 për Komunikimet Elektronike**, dhe kërkoi që komisioni të deklarohet nëse ka ndonjë propozim në amendamente, në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në raport, i cili do t'i dërgohen Komisionit Funksional.

Pasi nuk kishte vërejtje Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri, nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I.Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin **nr.04/L-109 për Komunikimet Elektronike** dhe ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve
- II .Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhje plenare të Kuvendit.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-95 për Diasporëne e Kosovës, me raportin e Komisionit funksional për Arsim, Kulture, Rini, Sport, AdministratëPublike, Qeverisje Lokale dhe Medija, me amandamante.

Kryesuesi, paraqet për shqyrtim propozim amendamentet në Projektligjin **nr.04/L-95 për Diasporëne e Kosovës** dhe kërkoi që komisioni të deklarohet nëse ka ndonjë propozim në amendamente, në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në raport, i cili do t'i dërgohen Komisionit Funksional.

Pasi nuk kishte vërejtje Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri, nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I.Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin **nr.04/L-95 për Diasporëne e Kosovës** dhe ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve
- II Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhje plenare të Kuvendit.

5. Të ndryshme

Kryesuesi- në fjalën e tij tha se të gjithë me kohë jemi njofuar se me datën 21.05.2012 do të mbahet takimi me komesarin e lartë për pakicat kombëtare. Temë diskutimi do të jetë, ‘Garancionet për mbrojtjen e pakicave pas mbikëqyrjes së pavarësiesë, politikës për gjuhët dhe politikës arsiumuese, sfidat për stabilitet dhe siguri’. Ai tha se tema i përket interesave të të gjitha komuniteteve andaj kërkoi që komisioni të jetë në përbërje të plotë për të dhënë kontribut rrheth mendimeve e sygjërimeve të veta.

Elmi Reçica - për pyetjen e fundit lidhur me mbledhjen me komesarin është i interesuar të dij se a ka ndonjë plan konkrete si do të rrjedh takimi, kush do ta marr fjalën meqë si temë është e gjerë dhe është në interes të gjithëve me qenë sa më më të informuar.

Nga se është kryetar i grupit punues në monitorimin e Ligjit nr.03/L- 047 për Mbrojtjen dhe promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, ai propozoi që administrata e komisionit pas dates 29.05.2012 të marr të gjitha veprimet e duhura për organizimin e tryezeës së rumbullakët, që gjate muajti qershor të përfundohet raporti i cili do të prezantohet në Kuvend.

Kryesuesi- për këtë temë kërkoi nga administrata të ofrohen informatat lidhur me ecurit e përgaditjes së tryezës së rumbullakët

Natasa Prica-Tisma - kordinatore e komisionit, tha se OSBE-ja ka inicuar një takim me komesaritatin e lartë për pakicat kombëtare të Norvegjisë, me tentim që kjo mbledhje të mbahet me të gjithë përfaqësuesit e komuniteteve të cilat përfaqsojnë komunitetet e tyre në komisionin Personeli mbështetës i ka kryer obligimet e veta lidhur me ftesat për komision, ku e njëjta iu është dërguar edhe anëtarëve të këtij komisioni me temën e cekur më lartë.

Xhevdet Neziraj - Me theks të veçantë tha se nuk është takimi i parë që do të mbahet me komesarin e lartë për pakica lidhur me temën për të drejtat e komuniteteve nga se ka pasur takime të tilla edhe në legjislacionet e më hershme. Në takime të tilla janë prezentuar problemet e komuniteteve dhe është diskutuar si dhe sa implementohen ligjet në Kosovë.

Ai ka vërejtje lidhur me javën e kultures së romëve, egjiptianëve dhe ashkalinjeve ku është organizuar një koncert nga Qeveria në bashkpunim me OSBE-në dhe BE. Në koncert është ftuar të këndoj një këngare romë dhe jo një egjiptian/e. Ai cekur se mos prania e komunitetit të tij është jo e drejtë dhe shtoi se më mirë kishte qenë që mjete të cilat janë shpenzuar për këtë lloj manifestimi të shfrytëzoheshin për punësim të qytetarëve të komunitetit ton.

Albert Kinolli - pajtohet plotësisht me z. Xhevdet me që secili ka të drejtë të mbroj identitetin e vet kombëtar me që këtë e mbron edhe akti më i lartë ligjor, Kushteta e Republikës Kosovës. Lidhur me këtë iniciativë ka dëgjuar para disa ditëve dhe njëherit është ftuar si mysafir në hapjen solemne, për një fjalë rasti. Ai ngrii një çështje tjetër që ka të bëjë me procesin e rintegritit të personave të riatdhezuar të pakicave si romë, ashkali, egjiptian, Theksoi se ky është proces shumë i ndjeshëm pasi në varësi të këtij procesi lidhet edhe liberalizimi i vizave për Kosovë.

E mira e këtij procesi është rruga e decentralizimit pasi kompetencat kanë kaluar në komuna Qytetarë të cilët do të kthehen nga shtetet e jashtme secili do të kthehet në komunën e vet përkatse Këto kompetenca i kanë zyrët për komunitete të cilat e dinë në thelb problematikën e komuniteteve në procesin e rintegritimit të personave të riatdhesuar. Ka njohuri se në komuna të caktuara ky proces nuk është duke shkuar siq është menduar apo siq kërkojm ne, andaj nuk duhet që fati i persoanve që kthehen të mbetet në duar të idividëve të pa përgjegjshëm.

Në emër të tij dhe në emër të komunitetit romë kërkoi mbështetje e kolegëve që në një të ardhme shumë të afërt si komision të vizitohen këto komuna që të shihet për se afërmi realizimi dhe suksesi i këtij procesi nga se nuk është e drejtë që baren e këtij procesi ta marrim ne kur përgjegjës është dikush tjetër

Të gjithë jemi të prirur dhe thirrur të japim kontributin tone andaj propozoi që të vizitohen zyrat që mirren me këtë proces për të parë sa njerëz janë kthyer.

Jemi në dijeni se Qeveria e Republikës së Kosovës ka ndarë një fond prej 3.4 milion euro ndërsa ata thonë se nuk ka buxhet, kuse sot ka njerëz që ende bredhin rrugëve dhe se çështja e tyre ende nuk është e zgjidhur.

Elmi Reçica- iu përgjigj parafolësit që si deputet i komunitetit romë dhe si përfaqësues i grupit 6+, se kryeministri z.Hashim Thaqi ka mbajtur takim dhe ka qortuar jo vetëm ministrant por edhe stafin përcjelles sa i përket detyrave që rrjedhin në raport me inegrimin në BE. Si komision jemi shumë të interesuar që ky process të mos devijoj nga se është gjithë logjistikat përcjellëse, janë hapur zyrat për atë qëllim.

Ministria për integrime ka bërë vizita në të gjitha komunat dhe ka kërkuar domosdo të angazhohemi në procesin e kthimit sepse është i domosdoshëm sidomos për shkak të liberaizimit të vizave por edhe për inegrime tjera që do të pasojnë. Shprehu interesimin e tij që të kontribohet në këtë drejtim, beson që edhe kryetari është i mendim të njëjtë andaj mbetet vetëm të specifikohet kur do të vizitohen zyrat Ai shtoi se nëse është nevoja këtë çështje do ta ngrisim edhe Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Rasim Demiri- mendon që çdo komunitet i ka problemet e veta dhe më së miri është që se secili të prezentojë problematikën me shkrim, kjo do ishte mënyra më reale e organizimit të takimit me komesarin Belg.

Xhevdet Neziri - përsëri e muarr fjalën për të diskutuar lidhur me procesin e rintegritimit të personave të riatdhesuar, dhe u shpreh se si deputet kemi përgjegjësi për realizimin e këtij procesi. Nuk është faji i zyrës për komunitete sepse ata vetëm i evidentojn njerëzit që kthehen në komuna dhe bëjnë një kërkesë në njësin e Ministris së Punëve të Brendshme. Zyrat ankohen që nuk kanë buxhet ndërsa komuna ka vetëm sa për të ardhura personale dhe nuk ka buxhet për implementimin e këtij program. Pra ky procese është duke u zgatur nga se ka kërkesa të qytetarëve që kalon gjashtë muaj e nuk marrin përgjegje.

Pra këtë program e ka Ministria për Integrime Europiane dhe Ministria për Punë të Brendshme prandaj duhet të kontaktohet me këto zyra

Sa i përket buxhetit në vlerë prej 3 milion e gjysëm i cili është i pamjaftueshëm dhe i cili iu shpërndahet 30 komunave apo sa i ka Kosova i bie nga 100 mijë euro për komunë, andaj me këtë shumë nuk mundet me zgjidhet problemi i riatdhesimit. Mund të thuhet se ka qenë vullnet i mire i Qeverisë së Kosovës që ka ndar këto mjete për të ndihmuar qytetarëz që rikthehen Dhe njëherit propozoi që ato mjete të mos mbesin suficid.

Albert Kinolli - e kupton brengën e parafolsit nga se ky problem qëndron më pare por nuk ka është lëshuar në detaje pasi tash më Qeveria e Republikës të Kosovës e ka kry punën e vet. Zyra që merret ekskluzivisht me këtë çështje është urë lidhse për zgjidhjen e këtij problem nga se nëse kërkesat nuk ngriten apo adresohen nga Minisria e Punëve të Brendshme dhe Ministrinë për Inegrimë Europiane, atëher Qeveria nuk ka dorë në këtë drejtim. Qeveria ka bërë mjaftë duke ndar fonde emergjente për fazën e pare edhe pse dihet se ky fond është i pamjaftueshëm për zgjidhjen e problemit të të riatdhesimit. Për këtë arsye janë dedikuar këto mjete mirëpo kërkesat nuk vijn prej nivelit local në nivelin qëndror. Theksoi se për arsye të neglizhencës të njerëzve jo adekuat këto mjete janë transferuar nga viti i kalur në vitin 2012. Propozoi që komisioni të vizitojë komunat që ka numër më të madh të riatdhesuarve

Kryesuesi- kërkoj nga përfaqësuesja e OSBE-ja, z.Elita Vokshi që të informon komisionin lidhur me mënyren e funksionimit të punës të këtyre zyrave

Elita Vokshi - vitin e kalur kemi qenë së bashku me shumicën e kryetarëve të komisioneve të ndryshme në Komision Euorpien në Bruksel aty jemi takuar me zyrtar të shumtë, Kjo çështje është ngritë vet prej tyre dhe se proceduart e aplikimit të marrjes të mjeteve për të riadresuarit vitin e kaluar ka qenë shumë e komplikuar do me thënë prej momentit kur kanë aplikuar deri në momentin e lëshimit të fondeve ka zgjatë shumë dhe për këtë arsye ka mbetur fondi i pashfrytëzuar.

Ajo propozoi që në takim të veçant komisioni të ftoj një përfaqësues nga Ministria për Inegrimë Europiane për të marr spjegime adekuate se si qëndron gjendja në këto komuna

Xhevdet Nezir- ishte i mendimit që në mbledhjen e komisionit të ftohen zyrtar, si të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim ashtu edhe nga Ministria e Punve të Brendshme, të cilët do t'i dëgjonin kërkesat tona në rastet kur do të debatohet për çështjet e ndjeshme të komunitetit jo shumicë.

Elmi Reçica-pajtohem me të gjitha propozimet andaj kemi mundësi t'i ftojmë përfaqësuesit e Ministrisë se Punëve të Brendshme, të Integrimëve Eurpoian dhe Ministrisë për Komunitete dhe Kthim ku do të hartohet një plan lidhur me vizitat nëper komuna. Mendon se do shohim nëse mjetet janë përdorur në mënyr adekuate nese jo egzistojnë mekanizma dhe organe kompetntë që mirren me këto çështje.

Kryesuesi- konstatoi që në mbledhjet e ardhshme do të jetë rregull, në pikat në të ndryshme secili t'i parashtroj problemet e komunitetit të vetë në mënyrë që komisioni të jetë i informuar dhe nëse ka probleme do të dale me sygjerime konkrete.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetar i Komisionit

Goran Marinkovic